



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA V

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 63

Prishtinë, më 23.12.2016 në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-2

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Agim Çeku, Mufera Shinik, Kimete Bytyçi, Ali Berisha, Qerim Bajrami, Veton Berisha dhe Danush Ademi.

Munguan: Jasmina Zhivković, Fisnik Ismaili, Milka Vuletiq, Sasha Milosavljeviq dhe Slavko Simiq.

Pjesëmarrës të tjerë: përfaqësues nga OSBE-ja, Sanije Berisha; përfaqësuese nga KDI-ja, Agnesa Haxhiu; konsultante e Sekretariatit të KKK-së, Zijush Ahmeti dhe Celal Iliaz, Drejtorja për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

Stafi mbështetës i Komisionit: Natasha Prica-Tishma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: **Agim Çeku**, nënkryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

Rend i ditës

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit për mbikqyrjen e zbatimit të nenit 11, të Ligjit nr. 03 / L-149 për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës;**
- 3. Të ndryshme.**

- 1. Miratimi i rendit të ditës**

Agim Çeku, nënkryetar i Komisionit, konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

- 2. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit për mbikqyrjen e zbatimit të nenit 11, të Ligjit nr. 03 / L-149 për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës;**

Kyeuesi, e njoftoi Komisionin se grupi punues ka realizuar të gjitha fazat e monitorimit të nenit 11 të Ligjit për Shërbimin Civil, ku është bërë vlerësimi i gjendjes momentale mbi përfaqësimin e drejtë dhe proporcional të komuniteteve në sektorin publik në nivelin qendror dhe lokal. Grupi punues ka mbajtur edhe një takim ku janë harmonizuar qendrimet e tyre dhe sot para vetës e kemi raportin me rekomandime dhe njëherit kërkoi nga anëtarët e komisionit që i njëjti të marrë përkrahjen e plotë dhe si i tillë të procedohet për miratim në Kuvend.

Qerim Bajrami, propozoi që rekomandimi me numër një (1) të formulohet teksti në vijim:

Të implementohet në tërësi Neni 11, i Ligjit mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nga të gjithë mekanizmat e implementimit të ligjit në të gjitha nivelet duke siguruar përfaqësim të drejtë dhe proporcional të të gjitha komunitetëve jo shumicë në Kosovë në nivel qendror dhe lokal, ku secili institucion duhet të ndërmarr masa aktive dhe të veprorë në përputhje me frymën e ligjit për gjithëpërfshirje dhe të ndërmarr masa proaktive të bazuara me rregullorën nr. 04/2010 për procedurat e përfaqësimit të drejtë dhe proporcional të komuniteteve jo shumicë në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Me këtë propozim, pajtohet edhe anëtarja e Komisionit z. Myfera Sinik.

Qerim Bajrami, propozoi një rekomandim të ri, me tekstin si në vijim; Që Qeveria e Republikës së Kosovës, në harmoni me kompetencat e veta, të nxjerr masa të veçanta dhe të parasheh mjetet shtesë buxhetore për realizimin e kuotës minimale të punësimit të pjesëtarëve të komunitetit jo shumicë në Shërbimin civil, në nivelin qendror.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimeve, kryesuesi konstatoi se Komisioni unanimisht, nxorri këtë:

Përfundim

Në këtë mbledhje u miratua raporti me rekomandime për nivelin e zbatimit të ligjit për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës, dhe i njëjti të procedohet për miratim në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Mbledhja përfundoi në orën 10:30.

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit.

Nënkryetar i Komisionit,

Agim Çeku